



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Nr. 831 prot.

Tiranë, më 20.05.2025

V e n d i m

Nr. 28, datë 20.05.2025

Për vijim procedure për kandidatët që kanë aplikuar për titullin *akademik* në shkencën e historisë dhe kandidatët që kanë aplikuar për avancim në titullin *akademik*

Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e saj të datës 20.05.2025, referuar nenit 6 pika 2 të Ligjit nr. 53/2019 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar; nenit 7 të Statutit të saj; vendimit nr. 8 datë 12.02.2025 të Kryesisë *Për fillim procedure për avancim në titullin “akademik” dhe rishpallje e një vendi për titullin akademik*; Vendimit të Asamblesë nr. 12, datë 28.02.2025 *Për miratimin e veprimtarisë së ASH-së gjatë vitit 2024, programin dhe prioritetet e veprimtarisë së saj për vitin 2025, disa shtesa dhe ndryshime në statut dhe miratimin për fillim procedure për kandidatët që kanë aplikuar për avancim në titullin “akademik” dhe rishpallje e një vendi për titullin “akademik”*; Vendimit të Kryesisë nr. 18, datë 01.04.2025 *Për avancim në titullin “akademik” dhe rishpallje e një vendi për titullin “akademik” si dhe informacionit nr. 560/1 prot. datë 08.05.2025 Relacion teknik mbi verifikimin e dokumentacionit për kandidatët që kanë aplikuar për titullin “akademik” në shkencën e historisë dhe për kandidatët (akademikë të asociuar) që kanë aplikuar për avancim në titullin “akademik”, të komisionit teknik të verifikimit drejtuar asaj,*

Vendosi:

1. Të miratojë vijimin e procedurës së konkurrimit për kandidatët që plotësojnë kriteret e parashikuara në ligjin dhe statutin e ASH-së, të cilët kanë aplikuar për titullin *akademik*, në shkencën e historisë, si më poshtë:

- Prof. Romeo Gurakuqi

- Prof. Hamit Kaba

2. Të miratojë vijimin e procedurës së konkurrimit për kandidatët që plotësojnë kriteret e parashikuara në ligjin dhe statutin e ASH-së, të cilët kanë aplikuar për avancim në titullin *akademik* si më poshtë:

- Akad. asoc. Gëzim Hoxha

- Akad. asoc. Besnik Baraj

- Akad. Asoc. Stefan Çapaliku

3. Sekretari shkencor ngarkohet për zbatimin e ndjekjen e procedurave të përcaktuara në pikat 5, 6 dhe 7, të vendimit të kryesisë nr. 18, datë 01.04.2025 *Për avancim në titullin “akademik” dhe rishpallje e një vendi për titullin “akademik”*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Akad. Skënder GJINUSHI

